



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.222/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada Gllgjani dhe Adnan Konushevci, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesat Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), dega në Pejë, paraqitur kundër Partisë Liberale Egjiptiane (PLE), dega në Gjakovë, për shkak të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohen** si të pabazuara ankesat Anr.222/2019 dhe Anr.223/2019, të parashtruara nga (IRDK), dega në Pejë, me të cilën kërkohet që t'iu shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Partisë Liberale Egjiptiane (PLE), dega në Gjakovë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

## A r s y e t i m

Me datën 04.10.2019, PZAP-i ka pranuar dy ankesa nga IRDK me seli në Pejë, me të cilën pretendohet se antëtari dhe militanti i subjekteve politike PLE ka përdorur gjuhën denigruese, fyerse dhe ofendime të rënda në rrjetin social facebook kundër subjektit politik IRDK. Ndërsa në ankesën Anr.223 pretendohet se një aktivist nga subjekti politik PLE ka kërcënuar një aktivist nga subjekti politik IRDK.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e LZP-së

Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur bisedën e printuar lidhur me rastet në fjalë.

Paneli i PZAP -it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me Anr.122/2019, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Në përgjigjet në ankesat e datës 05.10.2019, subjekti politik PLE, thekson se ankesa e parashtruar nga subjekti politik IRDK është e pabazuar, ngase personi i cili ka përdorur gjuhë të tillë nuk janë militant dhe pjesë të subjektit politik PLE, ata janë vetëm qytetarë të cilët kanë shfrytëzuar emrin e subjektit politik PLE.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesat vlerësoi se:

## **Ankesat janë të pa pabazuara**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik PLE, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 par 1 pika I të LZP-së b) të LZP-së, për arsye se shkeljet e pretenduara në ankesë nuk ka të bëjë me nxitje të urrejtjes në fushatën zgjedhore, *gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: Përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokoj një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*". Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesave, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në ankesa pasi që nuk mund të identifikohen personat me të cilën kanë shkëmbyer bisedat ne rrjeton social, në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë dhe në kuptim të nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.222/2019 më datën 05.10.2019.

**Kryesuese e Panelit  
Kymete Kicaj**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*